



THE STATE EDUCATION DEPARTMENT /
THE UNIVERSITY OF THE STATE OF NEW YORK / ALBANY, NY 12234

Lissette Colon-Collins, Assistant Commissioner | Office of Bilingual Education and World Languages

55 Hanson Place, Room 594
Brooklyn, New York 11217
Tel: 718-722-2445 Fax: 718-722-2459

89 Washington Avenue, Room 528EB
Albany, New York 12234
Tel: 518-474-8775 Fax: 518-474-7948

KARTA E TË DREJTAVE TË PRINDËRVE PËR NXËNËSIT E GJUHËS
ANGLEZE TË SHTETIT TË NJU-JORKUT

"Commissioner Regulations Part 154" e Departamentit të Arsimit të Shtetit të Nju-Jorkut (The New York State Education Department, NYSED) ju jep juve - prindërve/kujdestarëve të nxënësve të gjuhës angleze (English Language Learners, ELLs):

1. Të drejtën që fëmijët tuaj të marrin arsim publik falas në rajonin shkollor ku banoni, pavarësisht nga statusi i imigrimit tuaj apo i fëmijës suaj (p.sh. pavarësisht nëse anëtarët e familjes tuaj janë nënshjetas, imigrantë ose pa dokumente) dhe pavarësisht nga gjuha që flisni ju dhe fëmijët tuaj.
2. Të drejtën t'i regjistroni fëmijët tuaj në shkollë pa ju kërkuar që të jepni informacion ose dokumente që mund të tregojnë statusin e imigrimit tuaj ose të fëmijëve tuaj. Nuk mund t'ju kërkohej që të jepni kartën ose numrin e sigurimeve shoqërore (social security card), vizën e imigrimit ose statusin e vizës, ose dokumentet e nënshjetësive apo statusin e nënshjetësive.
3. Të drejtën, sipas ligjit federal, për të pasur një përkthyes të kualifikuar në gjuhën tuaj të preferuar për komunikime kritike me rajonin e shkollës.
4. Të drejtën që fëmijët tuaj të futen në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education, BE) kur ka 20 a më shumë nxënës të klasës që flasin të njëjtën gjuhë kryesore/të shtëpisë. [1]
5. Të drejtën për njoftim me shkrim në anglisht dhe në gjuhën tuaj të preferuar se fëmijët tuaj janë identifikuar si nxënës të gjuhës angleze (ELL) dhe se do të futen në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education) ose të anglishtes si gjuhë e re (English as a New Language) (të quajtur më parë "anglishtja si gjuhë e dytë"). [2]
6. Të drejtën për një sesion orientimi me cilësi të lartë, të ofruar nga rajoni juaj shkollor, i cili përqendrohet në standardet shtetërore, provimet dhe çka pret shkolla nga nxënësit e gjuhës angleze (ELL), si dhe synimet e programit, dhe kriteret për arsimin dygjuhësor (Bilingual Education) dhe anglishten si gjuhë e re (English as a New Language). Ky orientim duhet të bëhet para vendosjes përfundimtare në programin shkollor dhe duhet të bëhet në gjuhën tuaj të preferuar.
7. Të drejtën për të marrë informacion për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve tuaj në anglisht, si edhe për zhvillimin gjuhësor të tyre në gjuhën që flasin në shtëpi, në qoftë se janë në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education).
8. Të drejtën për t'u takuar me stafin e shkollës të paktën një herë në vit, përveç takimeve të tjera që kërkohen në përgjithësi, për të diskutuar përparimin e përgjithshëm të fëmijëve tuaj në mësim dhe zhvillimin e tyre gjuhësor.
9. Të drejtën që fëmijët tuaj të futen në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education) ose të anglishtes si gjuhë e re (English as a New Language) brenda 10 ditësh që prej regjistrimit të tyre dhe të

drejtën për të mos u futur në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education). Minimumi, fëmijët tuaj duhet të marrim mësim në anglisht si gjuhë të re (English as a New Language).

10. Të drejtën që fëmijët tuaj të transferohen në një shkollë tjetër në rajonin tuaj, e cila ofron arsim dygjuhësor (Bilingual Education) në gjuhën tuaj, në qoftë se shkolla fillestare e fëmijëve tuaj nuk e ofron një program të tillë.
11. Të drejtën që fëmijët tuaj të kenë mundësi të barabartë për të hyrë në të gjitha programet dhe shërbimet e ofruara nga rajoni shkollor, të përshtatshme për moshën dhe nivelin e klasës duke përfshirë ato që kërkojnë për mbarimin e shkollës dhe të gjitha programet e shkollës në dispozicion të nxënësve të tjerë.
12. Të drejtën që fëmijët tuaj të marrin mësim në të gjithë lëndët themelore dhe të mësojnë anglisht dhe lëndë të tjera të tilla si lexim/gjuhë, matematikë, shkencë dhe studime shoqërore në të njëjtin nivel akademik si të gjithë fëmijët e tjerë. E drejta për shërbime të mësimi të gjuhës angleze (ELL) nuk e kufizon aftësinë për të marrë mësim në lëndët themelore.
13. Të drejtën që fëmijët tuaj të kenë mundësi të plotë për të marrë pjesë në aktivitete jashtëshkollore (klubet pas shkolle, sportet etj.). E drejta për shërbime të mësimi të gjuhës angleze (ELL) nuk e kufizon aftësinë për të marrë pjesë në aktivitete jashtëshkollore.
14. Të drejtën që fëmijët tuaj të marrin shërbime mbështetëse (p. sh. shërbime të ndërhyrjes akademike - Academic Intervention Services) përkrah çdo plani ndërhyrës që shkolla/rajoni u ofron të gjithë nxënësve.
15. Të drejtën që fëmijët tuaj të japin provim çdo vit për të përcaktuar përparimin e tyre në gjuhën angleze dhe për të marrë informacion për arritjet e fëmijëve tuaj në provimet akademike duke përfshirë provimet e shtetit të Nju-Jorkut.
16. Të drejtën që fëmijët tuaj të regjistrohen vazhdimisht nga viti në vit në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education) ose të anglishtes si gjuhë të re (English as a New Language) ndërsa vazhdojnë të jenë nxënës të gjuhës angleze (ELL).
17. Të drejtën për të kontaktuar Zyrën e Arsimit Dygjuhësor të Departamentit të Arsimit të Shtetit të Nju-Jorkut (New York State Education Department's Office of Bilingual Education) dhe World Languages në qoftë se është shkelur ndonjëra prej të drejtave të mësipërme.

Ju lutemi telefononi **linjën e ndihmës për prindërit ELL (ELL Parent Hotline)** në numrin **1-800-469-8224**, ose dërgoni email te: nysparenthotline@nyu.edu

Për më tepër informacion, vizitoni: www.p12.nysed.gov/biling ose na shkruani në adresën:

New York State Education Department
Office of Bilingual Education & World Languages
55 Hanson Place, Room 594
Brooklyn, New York 11217

[1] Në qytetin e Nju-Jorkut sipas dekretit "Aspira Consent Decree", kërkohet një program i arsimit dygjuhësor (BE) për klasat K-8 në qoftë se 15 a më shumë nxënës të klasës flasin të njëjtën gjuhë gjatë dy vitesh të njëpasnjëshme shkollore. Në qoftë se në një shkollë nuk ka një numër të mjaftueshëm nxënësish që kualifikohen, por ka brenda për brenda rajonit të saj, rajoni duhet të ofrojë një program të arsimit dygjuhësor (BE).

[2] Të gjithë nxënësit e gjuhës angleze (ELL) i zhvillojnë aftësitë e tyre në anglisht nëpërmjet kurseve "Anglishtja si gjuhë e re" (English as a New Language). Përveç kësaj, ata që janë në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education) mësojnë gjithashtu edhe lëndën e gjuhës që flasin në shtëpi (Home Language Arts). Kurset e fushës së lëndëve themelore (d.m.th. matematika, shkenca dhe studimet shoqërore) ofrohen në programin e arsimit dygjuhësor (Bilingual Education) edhe në anglisht, edhe në gjuhën që flasin në shtëpi. Ata që nuk janë futur në një program të arsimit dygjuhësor (Bilingual Education) bëjnë kurse në fushën e lëndëve themelore në anglisht.